




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 440/1prot.

Shkodër, më. 07.07.2025

**Lënda:** Mbi Vendimet Nr. 32, 37, datë 26.06.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VOU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, neni 54, shkronjat “n”, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja “c”, dokumentacioni i mbledhjes të këshillit bashkiak bashkëlidhur u njoh me vendimet Nr. 32, 37, datë 26.06.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës akte me karakter njohës, për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja “a” e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin” i ndryshuar, nuk ka detyrim të shprehet.  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKT**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

**VENDIM**

Nr 32 . datë 26.06 . 2025

**PËR:**

**"Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Znj. Edona Ndue Molla"**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49 pika 1, neni 54 germa j, dhe propozimin e Komisionit të Mandateve, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në mbledhjen e datës 26.06 . 2025:

**VENDOSI**

1. Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës **Znj. Edona Ndue Molla** si pasojë e vakancës së krijuar nga Znj. **Kristjana Gjovalin Kovaçi**.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 dhe pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Kryetari Këshillit

**Ervis SHIMAJ**

Miratuar me 18 vota

Vota Pro 18

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me 01.07 . 2025



Sekretari Këshillit

**Ardian ÇELEPIJA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 3342 Prot.

Vau Dejës me 16 / 06 / 2025

**PROJEKT VENDIM**

**PËR:**

**"Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Znj. Edona Ndue Molla"**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 1,2,3, neni 54, germa j, si dhe në vendimin nr.1031 datë 09.05.2025 i KQZ, komisioni i mandateve i Këshillit Bashkiak Vau Dejës propozon të:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, Znj. **Edona Ndue Molla** propozuar nga subjekti politik, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, si pasojë e vakancës së krijuar nga Znj. **Kristjana Gjovalin Kovaçi**.

**KRYETARI KËSHILLIT**

**Ervis Shimaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

**RELACION**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, si pasojë e vakances së krijuar nga ish anëtarja e Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Znj. Kristjana Kovaçi, (neni 49 pika 4 germa e), dhe në bazë të nenit 49 pika 1,2,3 si dhe në vendimin nr.1031 datë 09.05.2025 të KQZ Tiranë për plotesimin e vakances në Këshillin Bashkiak Vau Dejes, me kandidatin nga lista shumëëmërore e Partisë Socialdemokrate e Shqipërisë Znj.Edona Ndue Molla, i propozojmë Këshillit Bashkiak Vau Dejës që në mbledhjen e radhës së muajit Qershor 2025, të miratojë mandatin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Znj.Edona Ndue Molla.

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 02/06/2025

Nr. 5024

**Lënda:** Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë Vau - Dejës

Rruga "Qafa e Gurit", Vau-Dejës

**Partisë Socialdemokrate**

Rruga "Skënderbej", Blloku i Ambasadave, Tiranë

**Zj. Edona Ndue Molla**

Vau-Dejës

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 09.05.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate" zj. Edona Ndue Molla.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 1031, datë 09.05.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Sekretar i Përgjithshëm**

(Në mungesë dhe me urdhër)

**Majlinda CELMETA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9.5.2025

Nr: 1031

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË VAU- DEJËS, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALDEMOKRATE", ZJ.  
EDONA NDUE MOLLA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJE

Me shkresën nr. 1681 prot., datë 14.04.2025, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Kristana Gjovalin Kovaçi, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialdemokrate".

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate", për Këshillin e Bashkisë Vau Dejës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 14, zj. Edona Ndue Molla.

Me shkresën nr. 3094, prot., datë 17.4.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës zj. Edona Ndue Molla, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Data: 9.5.2025 Nr: 1031  
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau -  
Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë  
Socialdemokrate" zj. Edona Ndue Molla"

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialdemokrate, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PSD-11903\_1\_2 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Edona Ndue Molla, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 3471 prot., datë 29.4.2025, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr.3470 prot., datë 29.4.2025, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për zj. Edona Ndue Molla.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesë sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Edona Ndue Molla.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 6670/1 prot., datë 2.5.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Edona Ndue Molla, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Edona Ndue Molla, në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

#### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

#### V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialdemokrate", zj. Edona Ndue Molla.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Hirjan CELIBASHI



Data: 9.5.2025 Nr: 1031  
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialdemokrate" zj. Edona Ndue Molla"